

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

L I G J

Nr.8781, datë 3.5.2001

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7850,
DATË 29.7.1994 "KODI CIVIL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 81 pika 2 shkronja 7d dhe të nenit 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 39 ndryshohet si vijon:

"Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj."

Neni 2

Pas nenit 39 shtohet neni 39/1 me këtë përmbajtje:

"Shoqata ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe me qëllimin e objektin e veprimtarisë së shoqatës, të parashikuar në statutin e saj.

Të ardhurat e realizuara nga shoqata duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e saj.

Nuk lejohet që shoqata të kryejë veprimtari fitimprurëse."

Neni 3

- Në nenin 40, para paragrafit të parë, shtohet ky paragraf:

"Akti për krijimin e shoqatës, me kërkesë të themeluesve të saj, regjistrohet në gjykatë".

- Fjalja e parë e nenit 40 ndryshohet si vijon:
"Rregullat për organizimin e funksionimin e shoqatës përcaktohen në statutin e saj, i cili duhet të hartohet me shkrim dhe të përmbajë sidomos:"

Neni 4

Në nenin 41, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:
"Shoqata themelohet nga mbledhja e themeluesve, në të cilën miratohet statuti dhe zgjidhen organet drejtuese të saj. Shoqata, me kërkesën e saj, regjistrohet në gjykatë sipas mënyrës së parashikuar në ligj."

Neni 5

Neni 42 ndryshohet si vijon:
"Shoqata fiton cilësinë e personit juridik nga dita e regjistrimit të saj në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e shoqatës mund të kryejnë veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e saj."

Neni 6

Neni 43 ndryshohet si vijon:
"Shoqata ka të drejtë të themelojë degë të saj kudo ku ajo e çmon të arsyeshme, për të realizuar qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqatës."

Neni 7

Pas nenit 43 shtohet neni 43/4 me këtë përmbajtje:
"Rastet dhe mënyrat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqatave nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj."

Neni 8

Në nenin 46, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:
"Anëtari i shoqatës nuk merr pjesë në diskutim dhe votim në rastet kur vetë ose bashkëshorti, fëmijët, gjinia a krushqia e tij janë në konflikt interesash me shoqatën, lidhur me një çështje të rendit të ditës.
Miratohen me shumicën e të gjithë anëtarëve të shoqatës vendimet për ndryshimin e statutit dhe për shpërndarjen e shoqatës, përveç kur në statut parashikohet një shumicë më e lartë votimi."

Neni 9

Në nenin 50, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:
"Anëtari, që largohet ose përjashtohet nga shoqata, përgjigjet për detyrimet e saj ndaj të tretëve deri në çastin e largimit të tij dhe nuk ka të drejta mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të saj."

Neni 10

Neni 52 riformulohet si vijon:

"Shpërndarja e shoqatës bëhet:

- a) me vendim të mbledhjes së përgjithshme të anëtarëve të saj;
- b) kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar në këtë Kod ose në statut;
- c) kur qëllimi i shoqatës është përmbushur ose nuk mund të përmbushet më;
- ç) kur vërtetohet se shoqata ka ushtruar veprimtari të kundërligjshme;
- d) në raste të tjera të parashikuara nga ligji.

Gjykata, në rastet e parashikuara në ligj, mund të vendosë shpërndarjen e shoqatës, me kërkesë të çdo anëtari të shoqatës, të organeve vendimmarrëse të saj, si dhe të organeve kompetente shtetërore."

Neni 11

Neni 53 ndryshohet si vijon:

"Kur vendoset shpërndarja e shoqatës, ajo vihet në likuidim dhe regjistrohet sipas rregullave të parashikuara në ligj."

Neni 12

Pas nenit 53 shtohet neni 53/1 si vijon:

"Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e shoqatës, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së saj, në përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar shoqata."

Neni 13

Neni 54 ndryshohet si vijon:

"Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut."

Neni 14

Neni 55 paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

"Fondacionet krijohen nga persona fizikë ose juridikë me akt noterial ose me testament. Akti për krijimin e fondacionit, me kërkesë të themeluesve të tij, regjistrohet në gjykatë."

Neni 15

Neni 56 ndryshohet si vijon:

"Fondacioni fiton cilësinë e personit juridik që nga dita e regjistrimit në gjykatë. Deri në ditën e regjistrimit, themeluesit e fondacionit ose ekzekutori i testamentit mund të kryejnë"

veprimet që janë të nevojshme për themelimin dhe përmbushjen e kushteve për regjistrimin e tij."

Neni 16

Pas nenit 56 shtohet neni 56/1 me këtë përmbajtje:

"Fondacioni ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, të realizojë të ardhura nëpërmjet administrimit të këtyre pasurive, si dhe ushtrimit të veprimtarive të tjera, në përputhje me ligjin dhe qëllimin e objektit e veprimtarive të parashikuara në statutin e fondacionit.

Të ardhurat e realizuara nga fondacioni duhet të përdoren vetëm për realizimin e veprimtarive që parashikohen në qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së parashikuar në statutin e tij.

Nuk lejohet që fondacioni të kryejë veprimtari fitimprurëse."

Neni 17

Neni 59 ndryshohet si vijon:

"Rastet dhe mënyra e mbikëqyrjes së veprimtarisë së fondacioneve nga organet kompetente shtetërore parashikohen shprehimisht në ligj."

Neni 18

Neni 60 shfuqizohet.

Neni 19

Neni 62 ndryshohet si vijon:

"Shpërndarja e fondacionit bëhet:

- a) me vendim të organit më të lartë vendimmarrës të tij;
- b) kur është përmbushur qëllimi për të cilin u themelua ose kur qëllimi i tij nuk mund të përmbushet më;
- c) kur vërtetohet se fondacioni ka filluar të ushtrojë veprimtari të kundërligjshme;
- ç) në raste të tjera të parashikuara me ligj.

Gjykata, në rastet e parashikuara me ligj, mund të vendosë shpërndarjen e fondacionit me kërkesë të çdo themeluesi të tij, të organeve vendimmarrëse të fondacionit, si dhe të organeve kompetente shtetërore."

Neni 20

Neni 63 ndryshohet si vijon:

"Gjykata, pasi të ketë marrë mendimin e subjektit që ka kërkuar shpërndarjen e fondacionit, vendos për destinimin e pasurisë që mbetet pas shpërndarjes së tij, në

përputhje me rregullat e parashikuara në statut, si dhe duke pasur parasysh destinacionin e tyre dhe qëllimin themelor për të cilin është themeluar fondacioni.

.....

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I
Skënder Gjinushi

www.shkpkk.org